



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2737/ 5 prot.

Datë 17.11.2025

V E N D I M
Nr. 1693/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK, me NIPT J61926006P, me adresë Autostrada Tiranë – Durrës, Km 16, Fshati Muçaj, Vorë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Klos.
Adresa: Rruga “Jaho Hoxha”, Ndërtesa nr. 2, Hyrja nr.2, Klos.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Power Industries” SHPK, me NIPT L92713601Q, me adresë Rruga “Xhorxh Soros” Lagjia “18 Shtatori”, Nr. 1524, Gjirokastrë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.06.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.

II.2. Në datën 13.06.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 17.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë

pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK	6,100,000	lekë skualifikuar
2. “Power Industries” SHPK	6,244,000	lekë skualifikuar
3. “Lexalko” SHA	6,485,000	lekë skualifikuar

II.4. Në datën 17.06.2025, operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Procedura e Prokurimit me Objekt: Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos me Fond Limit 6.727.550,00lek dhe Numër reference REF-49789-06-02, Operatori ekonomik:

1. Teknoxgroup Shqiperi me nipt: J61926006P, Ka paraqitur ofertë e tij, i cili në pikën 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë staf Teknik: a. Ing. Mekanik pjestar i liçencës së shoqërisë me kohë të plotë për të paktën 6 muaj para datës së hapjes së ofertave dhe të jetë në listë pagesa, ku për këtë duhen:

- a- Kontrate pune e vlershme,
- b- Diplome,
- c- CV.

Nuk e përmbush këtë kriter pasi në Kontratën e punës së paraqitur e lidhur ndërmjet Z. Ervin Kola punëmarrës dhe Teknoxgroup Shqiperi sh.p.k punëdhënës vërehet të jetë lidhur më datë 06/05/2025 dhe nuk e përmbush afatin kohorë për të paktën 6 muaj para date së hapjes së ofertave.

2. Teknoxgroup Shqiperi me nipt: J61926006P Ka paraqitur ofertë e tij, i cili në pikën: 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB): me KOD: VII.3.B.1 Nënkatëgoria: Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Nuk e përmbush këtë kriter pasi ka paraqitur Liçencën: LN-7299-04-2024 NUIS/NIPT: J61926006P Teknoxgroup Shqiperi me KOD VII.3.B data e lëshimit 2024-04-04 Afati i vlefshmërisë Prill 3-2029 Katëgoria Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor Nënkatëgoria: Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

3. Teknoxgroup Shqiperi me nipt: J61926006P, Ka paraqitur ofertë e tij, i cili në pikën 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën ose librezën e mjetit, foto të mjetit dhe të kovave të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe me përshkrimin e karakteristikave teknike të mjetit që ofron. Nuk e përmbush këtë kriter pasi ka paraqitur një broshurë e cila ka vetëm pamjen e mjetit dhe nuk ka foto të setit të kovave, kapjes së shpejtë dhe funksioneve të tjera të kërkuara të mjetit.

II.4. Në datën 20.06.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 20.06.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5445 dhe me numër 1599/2025 prot., datë 23.06.2025 e operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqiperi”, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1599/1 prot., datë 24.06.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1599/2025 prot, datë 23.06.2025.

II.7. Nëpërmjet postës elektronike zyrtare autoriteti kontraktor ka dërguar shkresën nr. 1352/4 prot, datë 04.07.2025 me objekt “Dërgim vendimi nr. 1352/4, datë 04.07.2025 për shqyrtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 1599/2 prot, datë 09.07.2025, nga verifikimii shkreës rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar edhe aktin e trajtimit të ankesës nr. 1352/3 prot, datë 04.07.2025 të operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës me argumentat si vijon:

Sipas KVO, Operatori Ekonomik: “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k., - s'kualifikuar, per arsyet si me poshte citojmë: Nuk permbush kriterin 2.3.2, 2.3.4 dhe 2.3.7, 1 Kapaciteti teknik, 2. Kriteret e Vecanta të Kualifikimit:

- *Operatori ekonomik duhet te kete staf teknik: Ing. Mekanik pjestar i licenses se shoqerise me kohe te plote per të paken 6 muaj para dates se hapjes se ofertave dhe të jete ne list pagesa, ku për kete duhen: a) kontrate pune e vlefshme, b) diplome, c) Cv. pika 2.3.2 Kriteret e Vecanta.*
- *Operatori Ekonomik duhet të disponoje Licence të leshuar nga Qendra Komberare e Biznesit (QKB): VII.3.B.1. nen kategoria: - Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio, pika 2.3.4 Kriteret e Vecanta.*
- *Operatori ekonomik duhet te paraqese katalog per mjetin ku te jete specifikuar produkti qe është paraqitur ne oferte dhe specifikimet teknike, per të gjetur pasqyrim per parametrat teknike te produktit (shih specifikimet telnike) te kerkuara nga autoriteti kontraktor dhe te ofruara nga operatori ekonomik, pika 2.3.7 Kriteret e Vecanta.*

Operatori ekonomik pjesemarres i s'kualifikuar "Teknoxgroup Shqiperi" Sh.p.k., duke mos qene dakort me s'kualifikimin e ofertes se tij, ka paraqitur ankesen per kundershtimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave, duke parashtruar pretendimet si më poshte citojme:

E kundershtojme skualifikimin tone me arsyetimin e KVO-se se OE "Teknoxgroup Shqiperi" Sh.p.k nuk ploteson kriterin 2.3.2. Ndryshe sa pretendon KVO, vertetohet se operatori pjesmarres "Teknoxgroup Shqiperi" sh.p.k permbush kushtin e kerkuar ne piken 2.3.2 per stafin teknik pasi: AK ka kerkuar qe operatori ekonomik te disponoje staf teknik: Ing. Mekanik pjestar i licenses se shoqerise me kohe të plote per te pakten 6 muaj para dates se hapjes se ofertave dhe të jete ne list pagesa: Per keta punonjes, ofertuesi duhet te paraqese:

- o a) kontratë pune e vlefshme.*
- o b) diplome,*
- o c) Cv.*

Sipas ligjit te Prokurimit Publik, rregullave te prokurimit publik, shoqeria jone ka paraqitur ne sistem dokumentacionin perkates per sa i perket ing.mekanik qe eshte pjesë e licences VII.3.B.1. Licenca eshte marre me date 03.04.2024 dhe parashikon se Z. Ervin Kola eshte pergjegjes teknik i OE, pra provohet se nga data 03.04.2024 Z. Kola ka ofruar sherbimet perkatese ne favor te OE. Kontatra e nënshkruar nga Z. Ervin Kola me date 06.05.2025 i referohet periudhes nga 01.01,2025 e ne vazhdim. Gjithashtu rezulton se Z.Ervin Kola ka pasur edhe kontrata te tjera me OE per periudhen 20.12.2022-20.12.2024.

Sipas KVO oferta e shoqerise "Teknoxgroup Shqiperi" sh.p.k skualifikohet se nuk ploteson kriterin 2.3.2, Ne nenin 26 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" pikat 1,2,3,6 dhe 7 te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarje ose te ofertave, autoriteli/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes të vetedeklarimit, sipas percaktimit ne nenin 82, te LPP-se, dhe ne keto rregulla. 2. Formulari pörmbledhes i vetedeklarimit permбан informacion dhe deklarimin, si me poshte vijon:

a) operatori ekonomik eshte i rregjistruar ne rregjistrin tregtar sipas legjislacionit te vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit te posaçem ne rastin e nje organizate jofitimprurese, ka ne fushen e veprimtarise objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv:

b) operatori ekonomik nuk eshte denuar per asnje nga veprat penale, te parashikuara ne piken 1, te nenit 76, te LPP-se;

c) personi/at ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut. ose qe ka kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk eshte ose ka qene i denuar me vendi gjyqesor te formes se prere për asnje nga veprat penale, te percaktuara ne piken 1, te nenit 76, te LPP-se;

ç) operatori ekonomik nuk eshte shpallur fajtor per shkelje te rende profesionale;

d) operatori ekonomik nuk eshte ne proces falimentimi:

- dh) operatori ekonomik ka paguar te gjitha detyrimet per pagimin e taksave dhe tatimeve te kontributeve te sigurimeve shoqerore, sipas parashikimeve te pikes 2, te nenit 76 te LPP-se;
- e) operatori ekonomik ka shlyer te gjitha detyrimet e maturuara te energjise elektrike, dhe permbush kerkesat qe rrjedhin nga legjislacioni i fushes ne fuqi. Ky informacion kerkohet per operatoret ekonomike, te cilet ushtrojne veprimtarine ne territorin e Republikes se Shqiperise;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet ne kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit ne fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin ne zbatim te kerkesave ligjore te legjislacionit mjedisor social dhe te punes;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur oferte te pavarur, sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi;
- gj) operatori ekonomik permbush specifikimet teknike, sipas kerkesave te percaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqine punetore, te nevojshme për ekzekutimin e kontrates, sipas kerkesave te autoritetit/entit kontraktor (kur shte rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makinerite e nevojshme per ekzekutimin e kontrates, sipas kerkesave te autoritetit/entit kontraktor, kur eshte rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do te mbeshtetet, nese eshte rasti dhe nenkontraktoret e mundshëm, nese eshte rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kerkesave te legjislacionit ne fuqi;
- Informacioni i pasqyruar ne formularin e vetedeklarimit, i cili gjendet ne nje baze te dhenash, ku autoriteti/enti kontraktor mund te aksesojë direkt kete informacion dhe /ose dokumentin, duhet te shoqerohet me adresen perkatese per kete baze te dhenash.
4. Per permbushjen e detyrimit sipas ketij neni, operatoret ekonomike mund te perdorin nje formular vetedeklarimi qe ishte perdorur gjate nje procedure prokurimi te meparshme, nese informacioni qe ajo permban vazhdon te jete i saktë dhe i vlefshem.
5. Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “I” dhe “j” te pikes 2, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Dokumentet duhet te jene ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me originalin.

Referuar argumentimeve mbi shkeljet e pretenduara te paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k ne ankesen e tij, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, analizoj dokumentacionin e paraqitur nga Njesia e Prokurimit, Kriteret e Kerkuara ne DST per te cilat jane objekt ankimi, verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga Operatori Ankimues “Teknoxgroup” Sh.p.k ne Sistemin e Prokurimit Elektronik, ne lidhje me kerkesen objekt ankimi te pikes 2.3.2 ne Kriteret e Vecanta, ne DST eshte kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te kete staf teknik: Ing. Mekanik pjestar i licenses se shoqerise me kohe te plote per te pakten 6 muaj para dates se hapjes se ofertave dhe te jete ne list pagesa, ku për kete duhen: a) kontrate pune e vlefshme, b) diplome, c) Cv, pika 2.3.2 Kriteret e Vecanta.

Referuar pretendimit per mos permbushje te pikes 2.3.2 Kapaciteti teknik te Krieteve te Vecanta te Kualifikimit, vendimarrjes se dates 16.06.2025 te Komisionit te Vleresimit te

Ofertave, rezulton se, operatori ekonomik pjesemarres, shoqeria “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k., është s’kualifikuar per arsyet, si citojme:

Nuk e permbush kete kriter pasi ne kontraten e punes se paraqitur e lidhur ndermjet Z. Ervin Kola punemarres dhe Teknoxgroup Shqipëri sh.p.k punëdhënes verehet te jete e lidhur me date 06.05.2025 dhe nuk permbush afatin kohor per te pakten 6 muaj para dates së hapjes se ofertave.

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” Sh.p.k, rezulton se Operatori Ekonomik “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k ka lidhur kontrate me Z. Ervin Kola me date 06.05.2025. Nga permbajtja e kesaj kontrate rezulton qe eshte bere per afat kohe 01.01,2025-31.12.2026 nenshkruar me date 06.05.2025.

Ne menyre specifike tek kontrata e cila eshte ngarkuar ne sistem thuhet që afati i kesaj kontrate eshte nga data 01.01.2025-31.12.2026. Ne hirarkine e normave te Republikes se Shqiperise Kodi civil qendron mbi ligje dhe akte te tjera ligjore, qe do te thote nje kontrate e kesaj natyre nuk mund te kete fuqi prapa vepruese. Ky punonjes nuk mund te jete ne list pagesa nese nuk ka nje kontrate pune te vlefshme per periudhen e kerkuar.

Sa me siper, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.

Referuar pretendimit per mos permbushje te pikes 2.3.4 Kapaciteti teknik te Kriterëve te Veçanta te Kualifikimit, vendimarrjes se dates 16.06.2025 te Komisionit te Vleresimit te Ofertave, rezulton se, operatori ekonomik pjesemarres, shoqeria “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k., eshte s’kualifikuar per arsyet, citojme:

- Teknoxgroup Shqiperi sh.p.k me nipt: J61926006P Ka paraqitur oferten e tij i cili ne piken: 2.3.4 Operatori Ekonomik duher te disponoje Licence te leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB): VII.3.B.1, nen kategoria: - Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio. Nuk e permbush kete kriter pasi ka paraqitur licencen: LN-7299-04-2024 Nipt: J61926006P Teknoxgroup Shqiperi Sh.p.k me kod VII.3.B data e leshimit 2024-04-04 afat i vlefshmerise Prill 3-2029, kategoria Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale te lidhura me transportin rrugor. Nen Kategoria: Autoriparimi i mjeteve rugore me motor dhe rimorkiove.*

Referuar argumentimeve mbi shkeljet e pretenduara te paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k ne ankesën e tij, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, analizoj dokumentacionin e paraqitur nga Njesia e Prokurimit, Kriteret e Kerkuara ne DST per te cilat jane objekt ankimi, verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga Operatori Ankimues “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k ne Sistemin e Prokurimit Elektronik, ne lidhje me kerkesen objekt ankimi te pikes 2.3.4 ne Kriteret e Vecanta, ne DST eshte kerkuar:

- Operatori Ekonomik duher te disponoje Licence te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB): VII.3.B.I. nën kategoria: - Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit,*

te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio. Ne interpretim te percaktimeve ligjore dhe nenligjore te cituara me lart, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave vlereson se, nje oferte vlersohet e vlefshme nese ajo permbush te gjitha kerkesat konçize te kerkuara dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, bazuar ne preventivin e procedures eshte kerkuar.

Referuar dokumentacionit te paraqitur, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave konstaton se, operatori ekonomik pjesemares (Ankimues) shoqeria “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k., ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar:

- Licence,

Dokumentacion qe eshte ne perputhje me kriterine kerkuar sipas pikes 2.3.4 Kriteret e Vecanta Pranimit/Kualifikimit ne DST. Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses vlereson se jemi perpara rastit ku jane paraqitur dokumentat e kerkuara ne perputhje me dokumentat e tenderit. Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses vlereson se Kriteri 2.3.4 i kushteve te Vecanta te DST-se, eshte i permbushur nga Subjekti Ofertues “Teknoxgroup Shqiperi” sh.p.k.

Sa me siper, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qendron.

Referuar argumentimeve mbi shkeljet e pretenduara te paraqitura nga operatori ekonomik ankimes “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k ne ankesen e tij, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, analizoj dokumentacionin e paraqitur nga Njesia e Prokurimit, Kriteret e Kerkuara ne DST per te cilat jane objekt ankimi, verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga Operatori Ankimes “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k ne Sistemin e Prokurimit Elektronik, ne lidhje me kerkesen objekt ankimi te pikes 2.3.7 ne Kriteret e Vecanta, ne DST eshte kerkuar:

- Operatori ekonomik duhet te paraqes katalog per mjetin, ku te jete specifikuar produkti qe eshte paraqitur ne oferte dhe specifikimet teknike, per te gjetur pasqyrim per parametrat teknike te produktit (shih specifikimet teknike) te kerkuara nga autoriteti kontraktor dhe te ofruara nga operatori ekonomik. Ne interpretim te percaktimeve ligjore dhe nenligjore te cituara me lart, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave vlereson se nje oferte vlersohet e vlefshme nese ajo permbush te gjitha kerkesat konçize te kerkuara dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, bazuar ne preventivin e procedures eshte kerkuar.

Referuar dokumentacionit te paraqitur, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave konstaton se, operatori ekonomik pjesemarres (Ankimues) shoqeria “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k., ka paraqitur:

- Certificate te konformitetit te mjetit.
- Katalogu i mjetit 304
- Foto te kovave dhe kapesit te shpejte

Dokumentacioni i paraqitur eshte ne gjuhen angleze, dhe referuar ligjit per prokurimin publik dokumentat duhet te jene shqip ose te perkthyer. Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses, pavarsisht

ligjit mori ne shqyrtim katalogun dhe vlereson se jemi perpara rastit qe pesha e mjetit nuk perputhet me kriterin e kerkuar.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses vlerson se Kriteri 2.3.7 i kushteve te Vecanta te DST-se, nuk eshte i permbushur nga Subjekti Ofertues “Teknoxgroup Shqiperi” sh.p.k.

Sa me siper, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.

Per sa me siper, ne mbeshtetje te nenit 114 pika 3 germa “b” te ligjit Nr. 162/2020, date 23.12.2020 “Per Prokurimin publik”, nenit 102 pika 1 germa “b” te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 285, date 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Komisioni I ngritur per shqyrtimin e Ankeses, unanimisht:

Vendosi:

1. Te pranoje pjeserisht ankesen e paraqitur nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqiperi” Sh.p.k procedura e prokurimit “E, Hapur e thjeshtuar”, prokurim elektronik, me numer reference: REF 49789-06-02-2025, me objekt: ‘Blerje makinerie per pastrimin e kanaleve vaditese te Bashkise Klos’, dhe me fond limit ne vleren: 6.727.550 (gjashte milion e shtateqind e njezet e shtate mije e peseqind e pesedhijete) leke pa TVSH, zhvilluar me date 13.06.2025, ora: 10.00.

2. Nje kopje e ketij vendimi t'i komunikohet Komisionit te Prokurimit Publik dhe operatorit ekonomik ankimues nga autoriteti kontraktor brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi.

3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 17.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK	6,100,000	lekë skualifikuar
2- “Power Industries” SHPK	6,244,000	lekë skualifikuar
3- “Lexalko” SHA	6,485,000	lekë skualifikuar

II.9. Në datën 17.06.2025, operatori ekonomik “Power Industries” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Procedura e Prokurimit me Objekt: Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos me Fond Limit 6.727.550 leke dhe Numër reference REF-49789-06-2025, Operatori ekonomik:

1. Poëer Industries me nipt: L51706022H, Ka paraqitur ofertë e tij, i cili në pikën 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB): me KOD: VII.3.B.1 Nënkatëgoria: Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Nuk e përmbush këtë kriter pasi ka paraqitur Liçencën: LN-5634-04-2023 NUIS/NIPT: L51706022H Poëer Industries me KOD VII.3.B data e lëshimit 2023-04-27 Afati i vlefshmërisë Apr 27 2028 Katëgoria Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor Nënkatëgoria: Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

2. Poëer Industries me nipt: L51706022H, Ka paraqitur ofertë e tij, i cili në pikën 2.3.5 Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij. Nuk e përmbush këtë kriter pasi në Autorizimi i paraqitur citohet: Start Co sh.p.k: Është Distributori jonë i autorizuar për produktet dhe serviset Wacker Neuson 2025. Ku në të cilin prodhuesi nu shprehet që kompania Strat Co sh.p.k ka të drejtën e autorizimit të palëve të treta.

II.10. Në datën 20.06.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Anulimit” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.11. Në datën 23.06.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5449 dhe me numër 1603/2025 prot., datë 23.06.2025 e operatorit ekonomik “Power Industries”, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi.

II.12. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1603/1 prot., datë 24.06.2025, me arsyet e skualifikimit që kundërshton me anë të ankesës me nr. 1603/2025 prot, datë 23.06.2025.

II.13. Nëpërmjet postës elektronike zyrtare autoriteti kontraktor ka dërguar shkresën nr. 1352/2 prot, datë 04.07.2025 me objekt “Dërgim vendimi nr. 1352/1, datë 04.07.2025 për shqyrtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 1603/2 prot, datë 09.07.2025, nga verifikimii shkreës rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar edhe aktin e trajtimit të ankesës nr. 1352/1 prot, datë 04.07.2025 të operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e ankesës me argumentat si vijon:

Bazuar ne Proçesverbalin Nr.1, date 16.06.2025 Per vleresimin e proçedures “E Hapur - e thjeshtuar”, prokurim elektronik, me objekt “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditese te Bashkise Klos” te mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, rezulton se pjesëmarrës kanë qenë 3 (tre) operatore ekonomik, dhe është vendosur skualifikimi i operatorëve ekonomike pjesëmarrës si me poshte:

- | | |
|---|----------------|
| 1. Operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” Sh.p.k | i skualifikuar |
| 2. Operatori ekonomik “Power Industries” Sh.p.k | i skualifikuar |
| 3. Operatori ekonomik “Lexalko” Sh.p.k | i skualifikuar |

Sipas KVO-se Operatori Ekonomik: “Power Industries” Sh.p.k., - s'kualifikuar, per arsyet si me poshte citojme:

Nuk permbush kriterin 2.3.4 dhe 2.3.5, 1. Kapaciteri teknik, 2. Kriteret e Veçanta te Kualifikimit:

- Operatori Ekonomik duhet te disponoje Licence te leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB): VII.3.B.1, nën kategoria: - Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe të motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio, pika 2.3.4 Kriteret e Vecanta.

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per llojin e mjetit te ofruar. Ne rastin e distributorit te autorizuar te paraqitet edhe dokumenti qe verteton se distributori eshte i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email etj. pika 2.3.5 Kriteret e Vecanta.

Operatori ekonomik pjesemarrës i s'kualifikuar “Power Industries” Sh.p.k., duke mos qenë dakort me s'kualifikimin e ofertes së tij, ka paraqitur Ankesën per kundërshtimin e vendimit te Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke parashtruar pretendimet si me poshte citojmë:

Ne nenin 26 “Formulari permbledhës i vetedeklarimit” pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 te V.K.M-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhës të vetedeklarimit, sipas percaktimit ne nenin 82, te LPP-se, dhe ne keto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetedeklarimit permban informacion dhe deklarimin, si me poshte vijon:

a) operatori ekonomik eshte i rregjistruar ne rregjistrin tregtar sipas legjislacionit te vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit te posaçem ne rastin e nje organizate jofitimprurese, ka ne fushen e veprimtarise objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv:

b) operatori ekonomik nuk eshte denuar per asnje nga veprat penale, te parashikuara ne piken 1, te nenit 76, te LPP-se;

- c) personi/at ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut. ose qe ka kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk eshte ose ka qene i denuar me vendi gjyqesor te formes se prere për asnje nga veprat penale, te percaktuara ne piken 1, te nenit 76, te LPP-se;
- ç) operatori ekonomik nuk eshte shpallur fajtor per shkelje te rende profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk eshte ne proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar te gjitha detyrimet per pagimin e taksave dhe tatimeve te kontributeve te sigurimeve shoqerore, sipas parashikimeve te pikes 2, te nenit 76 te LPP-se;
- e) operatori ekonomik ka shlyer te gjitha detyrimet e maturuara te energjise elektrike, dhe permbush kerkesat qe rrjedhin nga legjislacioni i fushes ne fuqi. Ky informacion kerkohet per operatoret ekonomike, te cilet ushtrojne veprimtarine ne territorin e Republikes se Shqiperise;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet ne kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit ne fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin ne zbatim te kerkesave ligjore te legjislacionit mjedisor social dhe te punes;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur oferte te pavarur, sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi;
- gj) operatori ekonomik permbush specifikimet teknike, sipas kerkesave te percaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqine punetore, te nevojshme për ekzekutimin e kontrates, sipas kerkesave te autoritetit/entit kontraktor (kur shte rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makinerite e nevojshme per ekzekutimin e kontrates, sipas kerkesave te autoritetit/entit kontraktor, kur eshte rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do te mbeshtetet, nese eshte rasti dhe nenkontraktoret e mundshëm, nese eshte rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kerkesave te legjislacionit ne fuqi;
- Informacioni i pasqyruar ne formularin e vetedeklarimit, i cili gjendet ne nje baze te dhenash, ku autoriteti/enti kontraktor mund te aksesojë direkt kete informacion dhe /ose dokumentin, duhet te shoqerohet me adresen perkatese per kete baze te dhenash.
4. Per permbushjen e detyrimit sipas ketij neni, operatoret ekonomike mund te perdorin nje formular vetedeklarimi qe ishte perdorur gjate nje procedure prokurimi te meparshme, nese informacioni qe ajo permban vazhdon te jete i saktë dhe i vlefshem.
5. Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “I” dhe “j” te pikes 2, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Dokumentet duhet te jene ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me originalin.

Referuar pretendimit per mos permbushje te pikes 2.3.4 Kapaciteti teknik te Kriterave të Veçanta te Kualifikimit, vendimmarrjes se dates 16.06.2025 te Komisionit te Vleresimit te Ofertave, rezulton se, operatori ekonomik pjesëmarrës, shoqeria “Power Industries” Sh.p.k..eshte s’kualifikuar per arsyet, citojme: Power Industries sh.p.k me nipt: L51706022H ka paraqitur oferten e tij i cili ne piken: 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te disponoje Licence te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB); VII.3.B.1, nën kategoria: - Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe te motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio, nuk

e permbush kete kriter pasi ka paraqitur licencen: LN-5634-04-2023 Nipt: L51706022H Power Industries Sh.p.k me kod VII.3.B data e leshimit 2024-04-27 afafi i vlefshmerise Prill 27 2028, kategoria Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale te lidhura me transportin rrugor. Nenkatgoria: Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

Referuar argumentimeve mbi shkeljet e pretenduara te paraqitura nga operatori ekonomik ankimues "Power Industries" Sh.p.k ne ankesen e tij, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, analizoj dokumentacionin e paraqitur nga Njesia e Prokurimit, Kriteret e Kerkuara ne DST per te cilat jane objekt ankimi, verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga Operatori Ankimues "Power Industries" Sh.p.k ne Sistemin e Prokurimit Elektronik, ne lidhje me kerkesen objekt ankimi te pikes 2.3.4 ne Kriteret e Vecanta, ne DST eshte kerkuar:

- Operatori Ekonomik duhet te disponoje Licence te leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB); VII.3.B.1, nën kategoria: - Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio. Ne interpretim te percaktimeve ligjore dhe nenligjore te cituara me lart, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave vlereson se, nje oferte vleresohet e vlefshme nese ajo permbush te gjitha kerkesat konçize te kerkuara dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, bazuar ne preventivin e procedures eshte kerkuar. Referuar dokumentacionit te paraqitur, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave konstaton se, operatori ekonomik pjesëmarrës (Ankimues) shoqeria "Power Industries" Sh.p.k., ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar:

- Licence,

Dokumentacion qe eshte ne perputhje me kriterin e kerkuar sipas pikes 2.3.4 Kriteret e Vecanta Pranimit/Kualifikimit ne DST. Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses, vlereson se jemi perpara rastit ku jane paraqitur dokumentat e kerkuara ne perputhje me dokumentat e tenderit. Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses vlerson se Kriteri 2.3.4 i kushteve te Vecanta te DST-se, eshe i permbushur nga Subjekti i Oferues "Power Industries" sh.p.k.

Sa me siper, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qendron.

Referuar argumentimeve mbi shkeljet e pretenduara te paraqitura nga operatori ekonomik ankimues "Power Industries" Sh.p.k ne ankesen e tij, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, analizoj dokumentacionin e paraqitur nga Njesia e Prokurimit, Kriteret e Kerkuara ne DST per te cilat jane objekt ankimi, verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga Operatori Ankimues "Power Industries" Sh.p.k ne Sistemin e Prokurimit Elektronik, ne lidhje me kerkesen objekt ankimi te pikes 2.3.5 ne Kriteret e Vecanta, ne DST eshte kerkuar: Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per llojin e mjetit te ofruar. Ne rastin e distributorit te autorizuar te paraqiter edhe dokumenti qe verteton se distributori eshte i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel. fax, email etj.. pika 2.3.5 Kriteret e Vecanta. Ne interpretim te percaktimeve ligjore dhe nenligjore te cituara me lart, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave vlereson se nje ofertë vleresohet e vlefshme nese ajo permbush te gjitha kerkesat konçize te kerkuara dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, bazuar ne preventivin e procedures eshte kerkuar.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se, operatori ekonomik pjesëmarrës (Ankimues) shoqëria “Power Industries” Sh.p.k., ka paraqitur:

- Deklaratë nga prodhuesi,
- Autorizim prodhuesi.
- Autorizim distributori,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit nga spe rezulton se është ngarkuar nga operatori ekonomik deklarata në anglisht dhe e përkthyer në shqip, e vertetuar nga noter me datë 12.06.2025. Në deklaratë thuhet (shqip): “Kjo leter konfirmon se Wacker Neuson Linz GmbH, prodhues me reputacion i pajisjeve të ndërtimit dhe makinerive të renda, autorizojmë distributorin tone zyrtar “Start Co” sh.p.k të lejojë kompaninë “Power Industries” sh.p.k të paraqes një ofertë për produktin tone, eskavator model ET42 në tenderin me nr. Reference REF-49789-06.02.2025 dhe datë e fundit për ofertën 13.06.2025.

Gjithashtu, Autorizimi ka të cituar në mënyrë specifike që shërben vetëm për këtë tender.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vlerëson se Kriteri 2.3.5 i kushteve të Vecanta të DST-se, është i përmbushur nga Subjekti Ofertues “Power Industries” sh.p.k.

Sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa me sipër, në mbështetje të nenit 114 pika 3 germa “a” të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, nenit 102 pika 1 germa “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Komisioni i ngritur për shqyrtimin e Ankesës, unanimisht:

Vendosi:

* **

1- Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” Sh.p.k procedura e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar”, prokurim elektronik, me numer reference: REF-49789-06-02-2025, me Objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, dhe me fond limit në vlerën: 6.727.550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) leke pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, ora: 10.00.

2- Një kopje e këtij vendimi t’i komunikohet Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorit ekonomik ankimues nga autoriteti kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.

3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.14. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime

nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

II.15. Me datë 10.07.2025, me Vendimin nr. 880/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
4. Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 1352/1, datë 04.07.2025, për operatorin ekonomik “Power Industries” SHPK dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
5. Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 1352/3, datë 04.07.2025, për operatorin ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
6. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorin ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
7. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
8. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK.
9. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
11. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.16. Me shkresën nr. 1545/1 prot., datë 21.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1599/8 prot., datë 22.07.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Klos., informon se ka zbatuar vendimin Nr.

880/2025, datë 10.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës por nuk ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK sipas përcaktimeve në vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025, konkretisht në pikën III.4. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën III.4, të vendimit KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.17. Me datë 28.07.2025, me Vendimin nr. 968/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në përputhje me përcaktimet e pikës III.4 të vendimit nr. 880/2025, datë 10.07.2025.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.18. Me shkresën nr. 1812 prot., datë 08.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1599/14 prot., datë 11.08.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Klos., informon se “Bazuar në shkresën tuaj nr. 1599/12 prot, datë 28.07.2025 për procedurën “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klosë kërkojmë të na sqaroni se si do të operojmë më tej me operatorin ekonomik, pasi komisioni prokurimit publik nëvendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025 ka marrë në konsideratë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri”, për pikën 2.3.7 në kriteret e vecanta në DST duke na vendosur në kushte të paqarta dhe konfuze për komisionin e vlerësimit të ofertave. Referuar vendimit tuaj parashtrohet se skualifikimi I këtij është konfuz dhe I paqartë ndërsa në dispozitivin e vendimit shpreheni për pranim pjesërisht të ankesës, ku rrjedhimisht ky operatorë ekonomik duhet të qëndrojë i skualifikuar ku edhe pas rivlerësimit nga ana e KVO, me vendimin nr. 968/2025, datë 28.07.2025, nuk keni lejuar AK të vijojë me zhvillimin e procedurës pasi nuk është përmbushur pika IV.3. Për sa më lartë

kërkojmë suportin tuaj, se çfarë veprimesh duhet të kryejë KVO-ja në përmbushje dhe për zbatim të pikës IV.3, me qëllim zbatimin e vendimit të KPP-së”. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka kërkuar suport në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës por sërish nuk ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK sipas përcaktimeve në vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025, konkretisht në pikën III.4, në këtë pikë komisioni ka argumentuar në mënyrë të qartë problematikën e konstatuar pasi nga njëra anë autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit citon kriterin 2.3.7 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ndërkohë që përshkrimi narrativ i arsyes së skualifikimit nuk përputhet me kriterin 2.3.7. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën III.4, të vendimit KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi, në të cilën Komisioni ndër të tjera ka përcaktuar se “Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të evidentojë qartë dhe saktë, se cilin kriter kualifikues konkret nuk përmbush operatori ekonomik ankimues nëpërmjetë dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike”. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik kërkesën për suprot në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës por nuk ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK sipas përcaktimeve në vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025, konkretisht në pikën III.4. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën III.4, të vendimit KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.19. Me datë 18.08.2025, me Vendimin nr. 1074/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në përputhje me përcaktimet e pikës III.4 të vendimit nr. 880/2025, datë 10.07.2025.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.20. Me shkresën nr. 1812/2 prot., datë 22.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1599/19 prot., datë 26.08.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Klos., informon se “Në lidhje me zbatueshmërinë e vendimit Nr. 880/2025, datë 10.07.2025, si dhe informacionin e dërguar nga AK Bashkia Klos më datë 21.07.2025, po ashtu vendimi Nr. 1074/2025 Komsionit Prokurimit Publik si dhe komunikimit pararendës që Autoriteti Kontraktor ka shkëmbyer me KPP, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me Nr. Ref-49789-06-02-2025, menjëherë Autoriteti Kontraktor me marrjen e vendimit Nr.880/2025 si dhe Vendimin Nr. 1074/2025 Komisionit Prokurimit Publik; ka vazhduar me hapat e mëtejshëm për zbatimin e vendimeve dhe rivlerësimin e procedurës së sipërcituar. Më datë 18.07.2025 Titullari i AK-së ka ngritur ngritur urdhërin për heqjen nga anulimi të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, për ti dhënë akses Komisionit të Vlerësimit të Ofertave KVO për të kryer veprimet përkatëse në zbatim të vendimit Nr. 880/2025 të KPP-së si dhe për të bërë rivlerësim të procedurës së prokurimit. Më datë 21.07.2025, KVO ka kryer të gjitha veprimet teknike dhe ligjore në SPE. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor konkretisht KVO kishte një paqartësi në vendimin Nr. 880/2025 të KPP-së, pas komunikimeve zyrtare midis AK-së dhe KPP-së, Komisioni vlerësimit të Ofertave më datë 22.08.2025, ka kryer rivlerësim të procedurës në zbatim të vendimit Nr. 880/2025, datë 10.07.2025, veprime që janë korrigjuar në SPE. Pas vënies në dijeni të kësaj shkrese jemi në pritje të vendimit tuaj për hapat e mëtejshëm kjo bazuar në vendimin Nr. 880/2025, pika 7 si dhe Vendimi Nr. 1074/2025 pika 2”. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar informon se ka zbatuar vendimit nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës por në rastin konkret në tejkalim të vendimit nr. 880/2025, datë 10.07.2025 duke kualifikuar një operator ekonomik për të cilin Komisioni në vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025, as në pjesën arsyetuese dhe as në dispozitivin e tij nuk është shprehur për një gjë të tillë, përkundrazi në pjesën arsyetuese, konkretisht në pikën III.4, Komisioni ka argumentuar në mënyrë të qartë problematikën e konstatuar pasi nga njëra anë autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit **citon kriterin 2.3.7 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ndërkohë që përshkrimi narrativ i arsyes së skualifikimit nuk përputhet me kriterin 2.3.7.** Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën III.4, të vendimit KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi, në të cilën Komisioni ndër të tjera ka përcaktuar se “**Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të evidentojë qartë dhe saktë, se cilin kriter kualifikues konkretë nuk përmbush operatori ekonomik ankimues nëpërmjetë dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike**”. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik kërkesën me të cilën informon se ka zbatuar vendimin nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës dhe në vënd që të rishikonte në mënyrë të qartë dhe të saktë arsyet e skualifikimit, ka kualifikuar operatorin ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në kundërshtim me

përcaktimet në vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025, konkretisht në pikën III.4. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën III.4, të vendimit KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi, por ka tejkaluar jo vetëm pjesën arsyetuese të tij por edhe pjesën urdhëruese dispozitivin e vendimit.

II.21. Me datë 29.08.2025, me Vendimin nr. 1159/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.*
- 2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në përputhje me përcaktimet e pikës III.4 të vendimit nr. 880/2025, datë 10.07.2025.*

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.22. Me shkresën nr. 1812/4 prot., datë 09.09.2025, me objekt “Mbi zbatimin e vendimit dhe rivlerësimin e procedurës”, protokolluar me tonën nr. 1599/25 prot., datë 11.09.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Klos., ka dërguar zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 880/2025, datë 10.07.2025, duke e rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës duke rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.23. Me datë 17.09.2025, me Vendimin nr. 1268/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025,*

me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.

2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.24. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 29.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1-	“Teknoxgroup Shqipëri” SHPK	6,100,000	lekë skualifikuar
2-	“Power Industries” SHPK	6,244,000	lekë skualifikuar
3-	“Lexalko” SHA	6,485,000	lekë skualifikuar

II.25. Në datën 29.09.2025, operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Në pikën 2.3.7 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Katalog për mjetin ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në Ofertë dhe Specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat Teknik të produktit (shih Specifikimet teknike) të kërkuara nga Autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga Operatori Ekonomik. Sipas dokumentave të ngarkuara në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, vërejmë se pesha e mjetit të cilin ka ofertuar operatori ekonomik është 4165 kg, kjo e paraqitur me foto të pllakatës së mjetit. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë llojë dokumentacioni apo informacion tjetër shtesë në lidhje me peshën e mjetit, ndërkohë në specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor pesha e mjetit është kërkuar jo më pak se 4300 kg, gjithashtu: Katalogu i ngarkuar në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, nuk është paraqitur në gjuhen shqipe për rrjedhojë Komisioni Vlerësimit të Ofertave teknikisht nuk mundet ta përkthejë. Për këtë arsyeje referuar dokumentacionit që ju keni paraqitur në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, oferta juaj nuk i përmbush specifikimet teknike të cilat janë kërkuar.

II.26. Në datën 30.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.27. Në datën 03.10.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5889 dhe me numër 2737/2025 prot., datë 06.10.2025 e operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri”, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit

të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi me argumentat si vijon:

Procedura e vlerësimit të ofertave është karakterizuar nga vendime kontradiktore, tërësisht arbitrare dhe te paargumentuara. Ne tërësi procedura e vlerësimit të ofertave është zhvilluar në kushtet e arbitraritetit dhe mungesës së transparencës në kundërshtim me nenin 3 e vijim të ligjit nr. 162/2020 rezulton se:

A. Pas paraqitjes së ofertave kvo e autoritetit kontraktor ka bërë vlerësimin e parë të procedurës për oë duke vendosur për refuzim të ofertës së paraqitur nga OE për mos përmbushje të pikës 2.3.3 dhe pikës 2.3.7 të shtojcës - kriteret e veçanta të kualifikimit.

B. Pasi OE ka paraqitur ankim dhe në vijim të vendimit të ksha, me datë 21.07.2025 KVO e autoritetit kontraktor ka bërë rivlerësimin e parë të procedurës për OE duke vendosur për refuzim të ofertës së paraqitur nga OE.

C. Në vijim, referuar vendimeve të KSHA, me datë 22.08.2025, KVO e autoritetit kontraktor ka bërë një rivlerësim të dytë të procedurës për oë duke korrigjuar shkeljet e konstatuara nga ksha dhe vendosur për pranimin e ofertës së paraqitur nga OE.

D. Në fundi, referuar vendimeve të ksha, me datë 09.09.2025, KVO e autoritetit kontraktor ka bërë një rivlerësim të tretë të procedurës për OE dhe vendosur për refuzimin e ofertës së paraqitur nga oë për mos përmbushje të pikës 2.3.7 të shtojcës - kriteret e veçanta të kualifikimit.

Bashkëlidhur argumentimet e Teknoxgroup shpk mbi shkeljet e komisionit të vlerësimit të ofertave në vlerësimin e ofertës të Teknoxgroup shpk. Në bazë të argumenteve bashkëlidhur, provohet se nuk qëndrojnë pretendimet për mos përmbushjen e kriterit - kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3.7 e cila parashikon se: 2.3.7 operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për mjetin, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (shih specifikimet teknike) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. KVO ka vendosur për refuzim të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Teknoxgroup Shqiperi sh.p.k. duke argumentuar në mënyrë të pambështetur dhe arbitrare se pesha e mjetit është me e vogël se 4300 kg. Referuar akteve të paraqitura në tender për pesha e makines të ofruar në tender është 4.362,27 kg që e plotëson kushtin e kërkuar nga AK-ja.

II.27. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2737/1 prot., datë 07.10.2025, me arsyet e skualifikimit që kundërshton me anë të ankesës me nr. 2737/2025 prot, datë 06.10.2025.

II.28. Me shkresën nr. 2689 prot, datë 10.10.2025 me objekt “Kthim përgjigje mbi ankesën A/2025/5889 të operatorit ekonomik Teknoxgroup Shqipëri SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2737/2 prot, datë 14.10.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës,

nga verifikimi i së cilës konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës me argumentat si vijon:

Ne lidhje me ankesën e Operatorit Ekonomik “Teknogroup Shqiperi” SH.P.K, me objekt: Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit të Vleresimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Teknogroup Shqiperi” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditese të Bashkisë Klos” me Nr. REF-49789-06-02-2025, me fond limit: 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) leke pa TVSH, zhvilluar në datën 13.06.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Klos, ju bejme me dije se këtë objekt ankimi nga operatori ekonomik “Teknogroup Shqiperi” SH.P.K, ka bërë ankese për këtë objekt prokurimi me nr. A/2025/5445 prot., datë 23.06.2025, me nr. Protokolli 1599/2025. Autoriteti Kontraktor Bashkia Klos e ka shqyrtuar këtë ankese dhe ja ka percjell shkresërisht Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorit tuaj ekonomik sipas shkresës me nr. 1352/4 prot., datë 04.07.2025.

Komisioni i Prokurimit Publik ka marrë në shqyrtim ankesën përkatëse dhe është shprehur me vendimet Nr. 880/2025, datë 10.07.2025 si dhe Vendimin Nr. 1268, datë 17.09.2025, ku i jep të drejtën Autoriteti Kontraktor për vazhdimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me Nr. REF.49789-06-02-2025 me fond limit: 6,727,550 (Gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) leke pa t.v.sh. Afati për paraqitjen e ankësë nga Operatorët Ekonomik është ezauruar nga ana e AK-së që nga momenti i anulimit të procedurës gjë e cila ka ndodhur në SPE me datë 20.06.2025 dhe në Buletinin e Njoftime Publike Nr. 32 datë 23 Qeshor 2025, ku Operatori Ekonomik “Teknogroup Shqiperi” SH.P.K, ka paraqitur ankesën e tijë në lidhje me këtë procedurë prokurimi me njëjtin objekt ankimi. Autoriteti Kontraktor Bashkia Klos, bazuar në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nuk mund të rishqyrtojë një ankësë me të njëjtin objekt të shqyrtuar, kur është shprehur me Vendim dhe Komisioni i Prokurimit Publik për të njëjtin objekt ankese.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

II.29. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankësës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqiperi” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “Në pikën 2.3.7 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Katalog për mjetin ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në Ofertë dhe Specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat Teknik të produktit (shih Specifikimet teknike) të kërkuara nga Autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga Operatori Ekonomik. Sipas dokumentave të ngarkuara në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, vërejmë se pesha e mjetit të cilin ka ofertuar operatori ekonomik është 4165 kg, kjo e paraqitur me foto të pllakatës së mjetit. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë llojë dokumentacioni apo informacion tjetër shtesë në lidhje me peshën e mjetit, ndërkohë në specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor pesha e mjetit është kërkuar jo më pak se 4300 kg,” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, të dokumentave standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Specifikime teknike për: **Makineri për pastrimin e kanaleve vaditëse** janë si më poshtë vijon:

NR	TË DHENAT	PËRSHKRIMI
1	Modeli Motorrit	Perkins ose model motorri të barasvlefshëm me të
2	Karburanti	Naftë
3	Viti prodhimit	Jo më i vjetër se viti 2020
4	Nr.i Cilindrave	Jo më pak se 3
5	Fuqia	Jo më pak se 29 KW
6	Emërtimi i gazrave	Stage 5
7	Pesha Totale	Jo më pak se 4300 kg
8	Fuqia e kovës	Jo më pak se 32 kN
9	Presioni i punës	Jo më pak se 220 Bar
10	Prurja Hidraulike	Jo më pak se 58 L/min

- Detaje të tjera:
- E pajisur me kapje të shpejtë.
- Linjë çekiçi hidraulik.
- Zinxhirë gome.
- AC
- Set 3 kova kapje të shpejtë.
- Të jetë me (2) dy nivele shpejtësie.
- Teh (thikë) nivelimi
- Mjeti duhet të jetë i ri jo më shumë se 20 orë pune.

Garancia: 2 vitet ose 2000 orë pune, cila të plotësohet më parë.

III.1.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për mjetin, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat teknike të produktit (shih specifikimet teknike) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik.

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të më sipër cituar, operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- 1- Dokumentin Katalog Makineri CAT 304 pdf (1005.9 kB).
- 2- Dokumentin Foto e Makinerive dhe Kovave pdf (714.7 kB).
- 3- Dokumentin Fotografi të Kovave pdf (488.6 kB).
- 4- Certificate Konformiteti pdf (839.7 kB).
- 5- Autorizim Prodhuesi.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.5. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare,

specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”.

III.1.7. Në nenin 40 pika 6 germa b) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të

drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.1.9. Referuar arsyes së skualifikimi të operatorit ekonomik ankimes “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK se të dhënat e paraqitura për peshën e mjetit nuk përputhen me kërkesat e specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në shtojcën 6, duke rezultuar jashtë kriterëve minimale të pranueshme, nga verifikimi i dokumenteve të tenderit Komisioni konstaton, se në pikën 2.3.7 të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si vijon: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për mjetin, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (shih specifikimet teknike) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik”*, ndërsa në shtojcën 6 *“Formulari i specifikimeve teknike”* autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar si vijon: *“...Pesha Totale Jo më pak se 4300 kg.”*. Nisur nga arsyja e skualifikimit Komisioni konstaton, se në përmbushje të kërkesave të mësipërme të autoritetit kontraktor, operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike SPE ndër të tjera dokumentacionin si vijon: *“1-Dokumentin Katalog Makineri CAT 304 pdf (1005.9 kB)”*. Nga verifikimi i shtojcës 6 *“Formulari i specifikimeve teknike”*, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar që pesha totale e mjetit duhet të jetë jo më pak se 4300 kg, ndërsa nga verifikimi i katalogut të paraqitur në SPE rezulton se pesha e mjetit jo vetëm që plotësohet por edhe tejkalohet nga ajo që është kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike. Në katalogun e dorëzuar në SPE Cat 3004 Mini Excavator përcaktohen pesha nga min 3925 kg deri në max 4375 kg dhe nga min 4025 kg deri në max 4475 kg. Referuar të dhënave teknike të paraqitura në dokumentacionin e ngarkuar nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK si dhe specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit kërkon pesha totale e mjetit të jetë jo më pak se 4300 kg. Dokumenti teknik katalog i dorëzuar nga operatori ekonomik jep dy vlera peshës edhe min edhe max, në këto kushte Komisioni gjykon, se të dhënat teknike të paraqitura në katalog dëshmojnë se pesha e mjetit të ofruar jo vetëm që përmbushet por edhe tejkalohet. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimes nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Vlen të theksojmë, se në çdo rast është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, të kërkojë nga operatori ekonomik që të vërtetojë përmbushjen e kriterëve kualifikuesë dhe specifikimeve

teknike. Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, si dhe neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK qëndron.

III.2. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor, komisioni vlerësimit të ofertave gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.2.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “Gjithashtu Katalogu i ngarkuar në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, nuk është paraqitur në gjuhen shqipe për rrjedhojë Komisioni Vlerësimit të Ofertave teknisht nuk mundet ta përkthejë. Për këtë arsyeje referuar dokumentacionit që ju keni paraqitur në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, oferta juaj nuk i përmbush specifikimet teknike të cilat janë kërkuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.2. Në datën 03.06.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit

6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.

III.2.3. Në datën 13.06.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.2.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 17.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

4. “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK	6,100,000	lekë skualifikuar
5. “Power Industries” SHPK	6,244,000	lekë skualifikuar
6. “Lexalko” SHA	6,485,000	lekë skualifikuar

III.2.5. Në datën 17.06.2025, operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

III.2.6. Në datën 20.06.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.2.7. Në datën 20.06.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5445 dhe me numër 1599/2025 prot., datë 23.06.2025 e operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqiperi”, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi.

III.2.8. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1599/1 prot., datë 24.06.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1599/2025 prot, datë 23.06.2025.

III.2.9. Nëpërmjet postës elektronike zyrtare autoriteti kontraktor ka dërguar shkresën nr. 1352/4 prot, datë 04.07.2025 me objekt “Dërgim vendimi nr. 1352/4, datë 04.07.2025 për shqyrtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 1599/2 prot, datë 09.07.2025, nga verifikimii shkresës rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar edhe aktin e trajtimit të ankesës nr. 1352/3 prot, datë 04.07.2025 të operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

III.2.10. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 17.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

4- “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK	6,100,000	lekë skualifikuar
5- “Power Industries” SHPK	6,244,000	lekë skualifikuar
6- “Lexalko” SHA	6,485,000	lekë skualifikuar

III.2.11. Në datën 17.06.2025, operatori ekonomik “Power Industries” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

III.2.12. Në datën 20.06.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Anulimit” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

III.2.13. Në datën 23.06.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5449 dhe me numër 1603/2025 prot., datë 23.06.2025 e operatorit ekonomik “Poëer Industries”, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi.

III.2.14. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1603/1 prot., datë 24.06.2025, me arsyet e skualifikimit që kundërshton me anë të ankesës me nr. 1603/2025 prot, datë 23.06.2025.

III.2.15. Nëpërmjet postës elektronike zyrtare autoriteti kontraktor ka dërguar shkresën nr. 1352/2 prot, datë 04.07.2025 me objekt “Dërgim vendimi nr. 1352/1, datë 04.07.2025 për shqyrtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Power Industries” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 1603/2 prot, datë 09.07.2025, nga verifikimii shkruës rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar edhe aktin e trajtimit të ankesës nr. 1352/1 prot, datë 04.07.2025 të operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e ankesës.

III.2.16. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

III.2.17. Me datë 10.07.2025, me Vendimin nr. 880/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
 2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
 3. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
 4. Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 1352/1, datë 04.07.2025, për operatorin ekonomik “Power Industries” SHPK dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 5. Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 1352/3, datë 04.07.2025, për operatorin ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 6. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorin ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
 7. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 8. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Power Industries” SHPK.
 9. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK.
 10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 11. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.2.18. Me shkresën nr. 1545/1 prot., datë 21.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1599/8 prot., datë 22.07.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Klos., informon se ka zbatuar vendimin Nr. 880/2025, datë 10.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH,

zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës por nuk ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK sipas përcaktimeve në vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025, konkretisht në pikën III.4. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën III.4, të vendimit KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.2.19. Me datë 28.07.2025, me Vendimin nr. 968/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.*
2. *Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në përputhje me përcaktimet e pikës III.4 të vendimit nr. 880/2025, datë 10.07.2025.*

3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

III.2.20. Me shkresën nr. 1812 prot., datë 08.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1599/14 prot., datë 11.08.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Klos., informon se “Bazuar në shkresën tuaj nr. 1599/12 prot, datë 28.07.2025 për procedurën “Blerje makinerie për pastrimin e kalnavele vaditëse të Bashkisë Klosë kërkojmë të na sqaroni se si do të operaojmë më tej me operatorin ekonomik, pasi komisioni prourimit publik nëvendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025 ka marrë në konsideratë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri”, për pikën 2.3.7 në kriteret e vecanta në DST duke na vendosur në kushte të paqarta dhe konfuze për komisionin e vlerësimit të ofertave. Referuar vendimit tuaj parashtrohet se skualifikimi I këtij është konfuz dhe I paqartë ndërsa në dispozitivin e vendimit shpreheni për pranim pjesërisht të ankesës, ku rrjedhimisht ky operatorë ekonomik duhet të qëndrojë i skualifikuar ku edhe pas rivlerësimit nga ana e KVO, me vendimin nr. 968/2025, datë 28.07.2025, nuk keni lejuar AK të vijojë me zhvillimin e procedurës pasi nuk është përmbushur pika IV.3. Për sa më lartë kërkojmë suportin tuaj, se cfarë veprimesh duhet të kryejë KVO-ja në përmbushje dhe për zbatim të pikës IV.3, me qëllim zbatimin e vendimit të KPP-së”. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik,

vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka kërkuar suport në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës por sërish nuk ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK sipas përcaktimeve në vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025, konkretisht në pikën III.4, në këtë pikë komisioni ka argumentuar në mënyrë të qartë problematikën e konstatuar pasi nga njëra anë autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit citon kriterin 2.3.7 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ndërkohë që përshkrimi narrativ i arsyes së skualifikimit nuk përputhet me kriterin 2.3.7. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën III.4, të vendimit KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi, në të cilën Komisioni ndër të tjera ka përcaktuar se *“Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të evidentojë qartë dhe saktë, se cilin kriter kualifikues konkret nuk përmbush operatori ekonomik ankimues nëpërmjetë dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike”*. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik kërkesën për suprot në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës por nuk ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK sipas përcaktimeve në vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025, konkretisht në pikën III.4. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën III.4, të vendimit KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.2.21. Me datë 18.08.2025, me Vendimin nr. 1074/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.*
2. *Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në përputhje me përcaktimet e pikës III.4 të vendimit nr. 880/2025, datë 10.07.2025.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.2.22. Me shkresën nr. 1812/2 prot., datë 22.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1599/19 prot., datë 26.08.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Klos., informon se *“Në lidhje me*

zbatueshmërinë e vendimit Nr. 880/2025, datë 10.07.2025, si dhe informacionin e dërguar nga AK Bashkia Klos më datë 21.07.2025, po ashtu vendimi Nr. 1074/2025 Komisionit Prokurimit Publik si dhe komunikimit pararendës që Autoriteti Kontraktor ka shkëmbyer me KPP, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me Nr. Ref-49789-06-02-2025, menjëherë Autoriteti Kontraktor me marrjen e vendimit Nr.880/2025 si dhe Vendimin Nr. 1074/2025 Komisionit Prokurimit Publik; ka vazhduar me hapat e mëtejshëm për zbatimin e vendimeve dhe rivlerësimin e procedurës së sipërcituar. Më datë 18.07.2025 Titullari i AK-së ka ngritur ngritur urdhërin për heqjen nga anulimi të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, për ti dhënë akses Komisionit të Vlerësimit të Ofertave KVO për të kryer veprimet përkatëse në zbatim të vendimit Nr. 880/2025 të KPP-së si dhe për të bërë rivlerësim të procedurës së prokurimit. Më datë 21.07.2025, KVO ka kryer të gjitha veprimet teknike dhe ligjore në SPE. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor konkretisht KVO kishte një paqartësi në vendimin Nr. 880/2025 të KPP-së, pas komunikimeve zyrtare midis AK-së dhe KPP-së, Komisioni vlerësimit të Ofertave më datë 22.08.2025, ka kryer rivlerësim të procedurës në zbatim të vendimit Nr. 880/2025, datë 10.07.2025, veprime që janë korrigjuar në SPE. Pas vënies në dijeni të kësaj shkrese jemi në pritje të vendimit tuaj për hapat e mëtejshëm kjo bazuar në vendimin Nr. 880/2025, pika 7 si dhe Vendimi Nr. 1074/2025 pika 2”. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar informon se ka zbatuar vendimit nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës por në rastin konkret në tejkalim të vendimit nr. 880/2025, datë 10.07.2025 duke kualifikuar një operator ekonomik për të cilin Komisioni në vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025, as në pjesën arsyetuese dhe as në dispozitivin e tij nuk është shprehur për një gjë të tillë, përkundrazi në pjesën arsyetuese, konkretisht në pikën III.4, Komisioni ka argumentuar në mënyrë të qartë problematikën e konstatuar pasi nga njëra anë autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit **citon kriterin 2.3.7 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ndërkohë që përshkrimi narrativ i arsyes së skualifikimit nuk përputhet me kriterin 2.3.7.** Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën III.4, të vendimit KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi, në të cilën Komisioni ndër të tjera ka përcaktuar se “**Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të evidentojë qartë dhe saktë, se cilin kriter kualifikues konkretë nuk përmbush operatori ekonomik ankimues nëpërmjetë dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike**”. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik kërkesën me të cilën informon se ka zbatuar vendimin nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës dhe në vënd që të rishikonte në mënyrë të qartë dhe të saktë arsyet e skualifikimit, ka kualifikuar operatorin ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në kundërshtim me përcaktimet në vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025, konkretisht në pikën III.4. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka marrë masat e nevojshme në zbatim të

përcaktimeve të bëra në pikën III.4, të vendimit KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi, por ka tejkaluar jo vetëm pjesën arsyetuese të tij por edhe pjesën urdhëruese dispozitivin e vendimit.

III.2.23. Me datë 29.08.2025, me Vendimin nr. 1159/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në përputhje me përcaktimet e pikës III.4 të vendimit nr. 880/2025, datë 10.07.2025.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.2.24. Me shkresën nr. 1812/4 prot., datë 09.09.2025, me objekt “Mbi zbatimin e vendimit dhe rivlerësimin e procedurës”, protokolluar me tonën nr. 1599/25 prot., datë 11.09.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Klos., ka dërguar zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 880/2025, datë 10.07.2025, duke e rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 880/2025 datë 10.07.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës duke rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 880/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.2.25. Me datë 17.09.2025, me Vendimin nr. 1268/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025,

me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.

2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

III.2.26. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 29.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1-	“Teknoxgroup Shqipëri” SHPK	6,100,000	lekë skualifikuar
2-	“Power Industries” SHPK	6,244,000	lekë skualifikuar
3-	“Lexalko” SHA	6,485,000	lekë skualifikuar

III.2.27. Në datën 29.09.2025, operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Në pikën 2.3.7 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Katalog për mjetin ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në Ofertë dhe Specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat Teknik të produktit (shih Specifikimet teknike) të kërkuara nga Autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga Operatori Ekonomik. Sipas dokumentave të ngarkuara në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, vërejmë se pesha e mjetit të cilin ka ofertuar operatori ekonomik është 4165 kg, kjo e paraqitur me foto të pllakatës së mjetit. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë llojë dokumentacioni apo informacion tjetër shtesë në lidhje me peshën e mjetit, ndërkohë në specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor pesha e mjetit është kërkuar jo më pak se 4300 kg, gjithashtu: Katalogu i ngarkuar në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, nuk është paraqitur në gjuhen shqipe për rrjedhojë Komisioni Vlerësimit të Ofertave teknikisht nuk mundet ta përkthejë. Për këtë arsyeje referuar dokumentacionit që ju keni paraqitur në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, oferta juaj nuk i përmbush specifikimet teknike të cilat janë kërkuar.

III.2.28. Në datën 30.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

III.2.29. Në datën 03.10.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5889 dhe me numër 2737/2025 prot., datë 06.10.2025 e operatorit ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri”, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit

të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi me argumentat si vijon:

Procedura e vlerësimit të ofertave është karakterizuar nga vendime kontradiktore, tërësisht arbitrare dhe te paargumentuara. Ne tërësi procedura e vlerësimit të ofertave është zhvilluar në kushtet e arbitraritetit dhe mungesës së transparencës në kundërshtim me nenin 3 e vijim të ligjit nr. 162/2020 rezulton se:

A. Pas paraqitjes së ofertave kvo e autoritetit kontraktor ka bërë vlerësimin e parë të procedurës për oë duke vendosur për refuzim të ofertës së paraqitur nga OE për mos përmbushje të pikës 2.3.3 dhe pikës 2.3.7 të shtojcës - kriteret e veçanta të kualifikimit.

B. Pasi OE ka paraqitur ankim dhe në vijim të vendimit të ksha, me datë 21.07.2025 KVO e autoritetit kontraktor ka bërë rivlerësimin e parë të procedurës për OE duke vendosur për refuzim të ofertës së paraqitur nga OE.

C. Në vijim, referuar vendimeve të KSHA, me datë 22.08.2025, KVO e autoritetit kontraktor ka bërë një rivlerësim të dytë të procedurës për oë duke korrigjuar shkeljet e konstatuara nga ksha dhe vendosur për pranimin e ofertës së paraqitur nga OE.

D. Në fundi, referuar vendimeve të ksha, me datë 09.09.2025, KVO e autoritetit kontraktor ka bërë një rivlerësim të tretë të procedurës për OE dhe vendosur për refuzimin e ofertës së paraqitur nga oë për mos përmbushje të pikës 2.3.7 të shtojcës - kriteret e veçanta të kualifikimit.

Bashkëlidhur argumentimet e Teknoxgroup shpk mbi shkeljet e komisionit të vlerësimit të ofertave në vlerësimin e ofertës të Teknoxgroup shpk. Në bazë të argumenteve bashkëlidhur, provohet se nuk qëndrojnë pretendimet për mos përmbushjen e kriterit - kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3.7 e cila parashikon se: 2.3.7 operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për mjetin, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (shih specifikimet teknike) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. KVO ka vendosur për refuzim të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Teknoxgroup Shqiperi sh.p.k. duke argumentuar në mënyrë të pambështetur dhe arbitrare se pesha e mjetit është me e vogël se 4300 kg. Referuar akteve të paraqitura në tender për pesha e makines të ofruar në tender është 4.362,27 kg që e plotëson kushtin e kërkuar nga AK-ja.

III.2.30. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2737/1 prot., datë 07.10.2025, me arsyet e skualifikimit që kundërshton me anë të ankesës me nr. 2737/2025 prot, datë 06.10.2025.

III.2.31. Me shkresën nr. 2689 prot, datë 10.10.2025 me objekt “Kthim përgjigje mbi ankesën A/2025/5889 të operatorit ekonomik Teknoxgroup Shqiperi SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2737/2 prot, datë 14.10.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës,

nga verifikimi i së cilës konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës me argumentat si vijon:

Ne lidhje me ankesën e Operatorit Ekonomik “Teknogroup Shqiperi” SH.P.K, me objekt: Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit të Vleresimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Teknogroup Shqiperi” SHPK ne proceduren e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditese të Bashkise Klos” me Nr. REF-49789-06-02-2025, me fond limit: 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njetzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) leke pa TVSH, zhvilluar në datën 13.06.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Klos, ju bejme me dije se këtë objekt ankimi nga operatori ekonomik “Teknogroup Shqiperi” SH.P.K, ka bërë ankese për këtë objekt prokurimi me nr. A/2025/5445 prot., datë 23.06.2025, me nr. Protokolli 1599/2025. Autoriteti Kontraktor Bashkia Klos e ka shqyrtuar këtë ankese dhe ja ka përcjell shkresërisht Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorit tuaj ekonomik sipas shkresës me nr. 1352/4 prot., datë 04.07.2025.

Komisioni i Prokurimit Publik ka marrë në shqyrtim ankesën përkatëse dhe është shprehur me vendimet Nr. 880/2025, datë 10.07.2025 si dhe Vendimin Nr. 1268, datë 17.09.2025, ku i jep të drejtën Autoriteti Kontraktor për vazhdimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkise Klos”, me Nr. REF.49789-06-02-2025 me fond limit: 6,727,550 (Gjashtë milion e shtatëqind e njetzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) leke pa t.v.sh. Afati për paraqitjen e ankësë nga Operatorët Ekonomik është ezauruar nga ana e AK-së që nga momenti i anulimit të procedurës gjë e cila ka ndodhur në SPE me datë 20.06.2025 dhe në Buletinin e Njoftime Publikimeve Nr. 32 datë 23 Qeshor 2025, ku Operatori Ekonomik “Teknogroup Shqiperi” SH.P.K, ka paraqitur ankesën e tijë në lidhje me këtë procedurë prokurimi me njëjtin objekt ankimi. Autoriteti Kontraktor Bashkia Klos, bazuar në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nuk mund të rishqyrtojë një ankësë me të njëjtin objekt të shqyrtuar, kur është shprehur me Vendim dhe Komisioni i Prokurimit Publik për të njëjtin objekt ankese.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

III.2.32. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

III.2.33. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.2.34. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.35. Në udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, parashikohet shprehimisht se:

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

III.2.36. Në nenin 80 pika 1, 2, 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:” përcaktohet se:

- “1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;
 - b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.
- 2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.
- 3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi.”

III.2.37. Në nenin 82 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se:

1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla.

Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”.

III.2.38. Në rastin konkret, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik “Teknogroup Shqipëri” SHPK, si dhe pretendimet e këtij të fundit të parashtruar në ankesë, KPP vëren, se momenti procedural i vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik mbi kriteret e kualifikimit, duhet të ishte data 17.06.2025, datë në të cilën referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezultoi të jetë përmbyllur dhe procesi i vlerësimit të ofertave nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, ku për operatorin ekonomik ankimues është dhënë tjetër arsye skualifikimi, nga ajo e rivlerësimit të datës 29.09.2025. Arsye për të cilën operatori ekonomik ankimues pas ankesës së bërë në datë 23.06.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, Komisioni Prokurimit Publik u shpreh me vendimin nr. 880/2025, datë 10.07.2025 duke vendosur pranimin e ankesës dhe detyrimin e KVO që të qartësojë, saktësojë arsyet e skualifikimit. Pra jo më kot ligjvënësi, në varësi të llojit të procedurës, ka parashikuar një afat kohor (20 ose 15 ditë) për procesin e vlerësimit të ofertave duke dhënë garanci për secilën prej palëve, si për KVO-në nga njëra anë për kryerjen e një vlerësimi të thelluar e transparent dhe me mundësinë edhe të kryerjes së verifikimeve pranë palëve të treta ose sqarimeve nga operatorët ekonomikë sa herë lind nevoja, ashtu dhe për operatorët ekonomikë pjesëmarrës që

pas procesit të vlerësimit të ofrave dhe publikimit të njoftimit të fituesit paraprak apo anulimit të procedurës të kenë mundësi të mbrojnë interesat e ligjshëm duke ushtruar të drejtën e ankimit në autoritet kontraktor dhe në KPP. Në këtë kuadër KPP gjykon, se brenda periudhës kohore që ligji parashikon, KVO e autoritetit kontraktor ka patur në dispozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve të të gjithë dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ky operator ekonomik apo kërkimin e sqarimeve të nevojshme për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, derisa të konkludonte me mbylljen e procesit të vlerësimit në sistemin e prokurimit elektronik me datë 17.06.2025, ku operatori ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK ka rezultuar i skualifikuar për mospërmbushje të kriterit 2.3.2, 2.3.4, 2.3.7.

Pra për vlerësuar të gjithë dokumentet e ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, KVO e autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural deri me datë 17.06.2025, kur ka përfunduar procesi i vlerësimit në SPE dhe njoftimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi vlerësimin për t’u shprehur në lidhje me përputhshmërinë e tyre me kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Legjislacioni i prokurimit publik e përcakton në mënyrë të qartë që një ofertë konsiderohet e vlefshme vetëm nëse ajo përmbush të gjitha kërkesat për kualifikim, fakt të cilin KVO e autoritetit kontraktor e ka shprehur me vlerësimin e datës 17.06.2025, ku operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK ka rezultuar i skualifikuar për mospërmbushje të kriterëve 2.3.2, 2.3.4, 2.3.7. KPP gjykon, se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për t’u ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore në procesin e vlerësimit të ofertave dhe vetëm në rastet e deklarimeve të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE dhe që shërbejnë si provë paraprake vlerësimi, KVO e autoritetit kontraktor me dokumentacionin e dorëzuar në rrugë shkesore mund të verifikojë përputhshmërinë e deklarimeve të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar në rrugë shkresore, çdo dokument tjetër për përmbushjen e kriterëve kualifikuese që nuk përmbushet nëpërmjetë formularit përmbledhës të vetëdeklarimit duhet të verifikohet dhe të vlerësohet deri në momentin e njoftimit të klasifikimit, çdo vlerësim apo rivlerësim i mëvonëshëm ndaj këtyre dokumentave pas momentit procedural të parashikuar nga ligjvënësi do të konsiderohet nul.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se rivlerësimi i datës 29.09.2025 në lidhje me arsyet e reja të skualifikimit sa i përketë gjuhës së katalogut për operatorin ekonomik ankimues “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK, do të konsiderohen si akt absolutisht i pavlefshme, pasi komisioni vlerësimit të ofertave moment procedural për tu shprehur në lidhje me

përmbushjen apo mospërmbushjen e kriterëve kualifikuese të hartuara nga autoriteti kontraktor e ka patur në datën 17.06.2025, moment të cilin komisioni vlerësimit të ofertave nuk e ka shfrytëzuar edhe pse operatori ekonomik ankimues dokumentacionin e ka patur të ngarkuar në sistem e prokurimeve elektronike. Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se “*Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.*” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se “*Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi*”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) *veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest).* Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike, duke e vënë në lidhje me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon, se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, konstaton se akti administrativ i Komisionit Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “*Teknoxgroup Shqipëri*” SHPK me arsye të reja skualifikimi, do të konsiderohet një akte administrative absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A, dhe në tejkalim të arsyetimit të vendimit nr. 880/2025, datë 10.07.2025 të Komisionit Prokurimit Publik. Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.*”, autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për kthimin e situatës juridike në gjendjen fillestare për operatorin ekonomik ankimues “*Teknoxgroup Shqipëri*” SHPK sa i përket arsyes të dytë të skualifikimit, në lidhje me gjuhën e katalogut. KPP gjykon, se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për t’u ndjekur nga ana e autoriteteve/enteve kontraktore në procesin e vlerësimit të ofertave, si në aspektin kohor ashtu dhe në atë procedural. Në rastin konkret KPP e gjykon të gabuar, si zbatimin ashtu dhe interpretimin e ligjit ana e KVO-së së autoritetit kontraktor. Pasi autoriteti kontraktor ka patur në dispozicion momentin procedural deri me datë 17.06.2025, kur ka përfunduar procesi i vlerësimit në SPE dhe njoftimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi vlerësimin për t’u shprehur në lidhje me përputhshmërinë e dokumenteve të operatorit ekonomik në SPE me kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat procedurale të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-prokurimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të

operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese *Inter Allia* në vendimin 15/2010 ka theksuar se “*parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore*”.

Sa më sipër, KPP gjykon, se arsyet e reja të skualifikimit sa i përketë gjuhës së katalogëve të dhëna për operatorin ekonomik ankimues janë kryer në shkelje të parashikimeve ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në SPE. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efikasitetit parashikuar në nenin 2 të LPP-së.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Teknoxgroup Shqipëri*” SHPK qendron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatorin ekonomik “*Teknoxgroup Shqipëri*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra*”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “*Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos*”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorin ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

